



Dalës-Izlasna

Nr. 11-789
Br.

Data 10.08.2021
Datum

KRITIKË



Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: Xhafer Gashi, kryetar i komunës së Obiliqit

pe:



**Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit
(ZKA), për Komunën e Obiliqit, viti financiar 2020**

Gusht, 2021

Plani i veprimt për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit (ZKA), për Komunën e Obiliqit, viti financiar 2020

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimi i menaxhmentit	Koha e planifikimit	Drejtoria/Zyrtari përgjegjës	Data
1	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave mbi pronën për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Rekomandimi është marrë parasysh edhe viteve tjera por situata e rënduar me pandemi këto dy vite ka krijuar prap vështirësi në realizim, prandaj do të merret më intenzivisht departamenti përgjegjës, që në kohën sa më të shpejt të bëhet verifikimi i kërkuar, duke përpiluar planin vjetor të specifikuar.	viti 2021 - 2022	DEFZH - Departamenti i Tatimit në Pronë	2021-2022
2	Të hyrat	Kryetari duhet të monitoroj realizimin efektiv të të hyrave duke analizuar shkaqet e rritjes së llogarive të pa arkëtuara dhe me raste, të sigurojë që të iniciohen procedura nëpërmes gjykatës apo përmbauesve për t'i mbledhur borxhet nga bizneset.	Meqenëse si situatë e rënduar edhe në fushën ekonomike ishte kjo periudhë, si rezultat i pandemisë, nuk kemi arritur progresë në këtë fushë, por Departamenti I bizneseve, do të bashkëpunojë ngushtë me ATK-në, që së bashku të gjejnë zgjidhje dhe bizneset të cilat nuk zhvillojnë më veprimtarinë e tyre të mbylljen sipas procedurave ligjore, ndërsa me pjesën tjetër të gjendet marrëveshje e përbashkët që të mbledhen borxhet e vjetra.	viti 2022	DEFZH - Departamenti i Biznesit	2022
3	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që plani i prokurimit do t'i përfshijë të gjitha kërkesat nga njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitetet të realizohen jashtë planit të prokurimit, dhe në raste specifike kur aktiviteti nuk është përfshirë në plan, parapraktisht të njoftohet AQP. Po ashtu, kryetari të sigurojë që kërkesat nga njësitë kërkuese të planifikohen në bazë të nevojave reale si dhe furnizimet përmes kontratave publike komizë të mos tejkalojnë limitet e lejuara të devijimit prej +/- 30%.	Plani i prokurimit përpilohet dhe dorëzohet për çdo vit, për shkak të situatës së pandemisë kemi realizuar disa aktivitete shtesë/të paplanifikuara si dhe në disa kontrata është tejkaluar limiti +/-30%, në rastin e pastrimit të hapësirave publike, dezinfektimit, shërbimeve shëndetësore. Po ashtu në vitin 2020 deri pas muajit të katërt, nuk kemi pasur mundësi të tenderimeve për arsye të situatës me pandemi dhe buxhetit të dedikuar për këtë gjendje alarmuese në gjithë botë. Me zyrën e prokurimit dhe njësitë kërkuese, do të planifikohen planet vjetore duke u munduar të realizohen në përputhje me procedurat ligjore dhe nevojat komunale.	viti 2022	Prokurimi dhe të gjitha drejtoritë komunale	2022
4	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se funksionojnë kontrolltet në realizimin e kontratave në pajtim me kushtet kontraktuale. Menaxherët e kontratave të përgatitin planin për menaxhimin e kontratave dhe ta azhurnojnë me informatat plotësuese rreth realizimit dhe përmbylljes së kontratës si dhe të mbajnë shënime në ditarin e punës dhe librin ndërtimor për punët e realizuara. Po ashtu, kryetari duhet të sigurojë se bëhet ndarje e drejtë e detyrave dhe përgjegjësisve për zyrtarët të cilët janë pjesë e proceseve për të shmangur çfarëdo konflikti të mundshëm të interesit.	Në bashkëpunim me zyrën e Prokurimit, departamentit të infrastrukturës dhe menaxherëve të caktuar me vendim, bëhet përgatitja e planit të menaxhimit të kontratave dhe obligimet tjera që dalin nga ligjet në fuqi. Në disa kontrata specifike, në mungesë të stafit profesional dhe numrit të kufizuar të personeli profesional si arkitekt, inxhinier, ndërtimtar etj. ne jemi obliguar që me kapacitetet aktuale të bëjmë zgjidhje. Në vitin 2021, kemi bërë rikonstruktimin e brendshëm të stafit dhe sipas kërkesave të njësisve (departamenteve), kemi bërë një zgjidhje në këtë fushë.	viti 2021 - 2022	Prokurimi dhe të gjitha drejtoritë komunale	2021 - 2022
5	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë përmbushjen e kërkesave ligjore në përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-te, dhe raportimin e planit në ZKM në afatin e përcaktuar.	Kemi marrë parasysh këtë rekomandim dhe në vitin 2021 është përmbushur.	viti 2021	DSHMS, DKRS, DEFZH, DBZHR	2021

6	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se procesi i përzgjedhjes së projekteve për financim të zhvillohet duke aplikuar të gjitha kërkesat dhe formatet/formularët standard të përcaktuara me Rregulloren MF-Nr. 04 2017 për subvencionim të OJQ-ve. Përkrahjes financiare t'i paraprijë thirrja publike përmes së cilës përcaktohen qartë kriteret dhe kushtet tjera për pjesëmarrje që duhet të përmbushen nga përfituesit e mundshëm. Po ashtu, regjistrimi i shpenzimeve duhet të bëhet në kodet përkatëse të parapara në planin kontabël.	Kemi marrë parasysh këtë rekomandim dhe në vitin 2021 është përmbushur.	viti 2021	DSHMS, DKRS, DEFZH, DBZHR	2021
7	Investimet kapitale	Kryetari të siguroj kontrole dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Rekomandimi është marrë parasysh edhe viteve tjera por te kontratat e asfaltimeve ne kemi apliku skicat dhe paramasat e paralogaritë, ndërsa do ta kemi parasysh që sipas ligjeve dhe mundësive që kemi edhe për këto kontrata të hartojmë projektet si për të gjitha projektet dhe punimet që ne realizojmë.	viti 2022	DIL dhe drejtoritë tjera që kanë projekte të natyrës së tillë.	2022
8	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se pagesat e paradhënies të bëhen në pajtim me Ligjin e Buxhetit, në mënyrë që mos të ketë pagesa përtej limiteve të lejuara sipas kërkesave ligjore.	Kemi marrë parasysh këtë rekomandim dhe në vitin 2021 është përmbushur.	viti 2021	Të gjitha njësitë/drejtoritë	2021
9	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se në rastet kur aplikohen procedurat e prokurimit për kontratat me çmime për njësi, pesha të përcaktohet në bazë të rëndësisë që ka secila kategori e shërbimeve ose secili artikull, në mënyrë që të përcaktohet oferta më e lirë. Gjithashtu, të sigurojë ngritjen e nivelit të mbikëqyrjes nga menaxherët e kontratave, dhe rritjen e cilësisë së planifikimeve të nevojave nga njësitë kërkuese. Mekanizmat e kontrollit të përforcohen edhe në çertifikim të pagesave, me qëllim evitimin e pagesave të parregullta.	Së bashku me zyrën e prokurimit, infrastruktures dhe atë të financave është shqyrtuar rekomandimi dhe do të realizohet në vazhdimësi.	viti 2021/2022	zyra e prokurimit, DIL, DEFZH	2021/2022
10	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të siguroje se zyra e prokurimit pas nënshkrimit të kontratës përgatitë dhe dërgon me kohë urdhrin për blerje, e cila së bashku me zotimin e mjeteve financiare në SIMFK i paraprijnë furnizimit të mallrave dhe shërbimeve. Po ashtu duhet të siguroje se aplikohen ndëshkimet në rastet kur vonesat në realizim të kontratës nuk arsyetohen.	Kemi marrë parasysh këtë rekomandim dhe në vitin 2021 është përmirësuar e pritët të përmbushet në përgjithësi.	viti 2021/2022	zyra e prokurimit, DEFZH	2021/2022
11	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të siguroj se NJAB do të angazhohet që të përmbushë planin e auditimit në mënyre që t'i ofroj menaxhmentit një pasqyrë të qartë rreth funksionimit të organizatës ku pastaj të ketë mundësi që t'i marrë masat për t'i korrigjuar gabimet.	Situata me pandemi ka ndikuar në vonesat dhe po ashtu një mangësi tjetër qëndron edhe në mungesën e stafit në NJAB, ku ne kemi hapur konkursin për disa herë me radhë por në pamundësi të përmbylljes së tij, sipas rregullave e ligjeve në fuqi, ende nuk kemi plotësuar pozitën e anëtarit/zyrtarit në NJAB.	viti 2021/2022	NjAB, NjBNj	2021/2022

Kryetari i Komunes

Xhafer Gashi
Xhafer Gashi

